



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24.1.2025

Nr: 35

Ora: 13:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË BASHKISË
LEZHË, PËR PERIUdhËN 17 JANAR – 18 JANAR 2025

Sot, më datë 24.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Bashkia Lezhë

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Bashkisë Lezhë për periudhën 17 janar deri më 18 janar 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 17-18 janar 2025, Bashkia Lezhë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon.

- Trefzë diskutimesh, “Arsim”, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 21.1.2025,

Data: 24.1.2025 Nr: 35
Ora: 13:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Lezhë, për periudhën 17 janar – 18 janar 2025”

Nëpërmjet email-it të datës 22.1.2025, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Bashkisë Lezhë informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t'i paraqesë ato në seancën publike të datës 24.1.2025, ora 13:00.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive të Bashkisë Lezhë ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: *“Aktiviteti i raportuar nuk është realizuar dhe është shtyrë për datën 24 Janar. Kjo shtyrje e datës së realizimit të aktivitetet është bërë që në momentin që kemi aplikuar në sistem dhe ka rezultuar I NDALUAR si aktivitet kjo bazuar nenin 92, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 ,të Komisionit Rregullator i ndryshuar, në momentin që është bërë shtyrja është bërë dhe riraportimi me datën e re të aktivitetit”*.

Nga verifikimet e kryera në ndërfaqën e raportimeve rezulton se ky aktivitet është raportuar sërish brenda afatit ligjor.

Për sa më sipër, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se veprimtaria publike e zhvilluar nga Bashkia Lezhë, nuk përbën shkelje sipas parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Pasi veprimtaria ka marrë shënimin si e ndaluar, Bashkia Lezhë nuk e ka zhvilluar aktivitetin dhe e ka shtyrë. Në momentin që është bërë shtyrja është bërë dhe riraportimi me datën e re të këtij aktiviteti duke respektuar afatet ligjore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Lezhë.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI